

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.S. nga Prishtina, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 9 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par 1 të KPK-së, duke vendosur përkritazi me ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Prishtinë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar A.S., av. Xh.M. dhe mbrojtësit të akuzuarit G.S., av. H.M., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.12/2014, të datës 10.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, më datë 09.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Prishtinë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar dhe mbrojtësit të akuzuarit G.S., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.12/2014, të datës 10.10.2016, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.12/2014, të datës 10.10.2016, e ka shpallur fajtor të akuzuarin G.S., për shkak të veprave penale vrasje e rëndë nga neni 147 par 1 nën par. 9 të KPK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPK-së dhe për këto vepra penale e ka gjykuar me dënim me burgim afatgjatë në kohëzgjatje prej 27 (njëzet e shtatë) vjetësh, në të cilin i ka llogaritur edhe kohen e kaluar në paraburgim nga data 03.10.2011 e gjer në plotfuqishmërinë e aktgjyqimit.

Të akuzuarin e ka detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 200 (dyqind) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara A.S., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore - DKR në Prishtinë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

-Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av. Xh.M., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit G.S., av. H.M., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që i akuzuari G.S. të shpallet fajtor për vepër penale vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor nga neni 148 të KPK-së, ose eventualisht për veprën penale vrasje nga neni 146 të KPK-së apo i njëjti të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorinë e Apelit, të dëmtuarën, përfaqësuesin e autorizuar të dëmtuarës, të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av. Xh.M., i akuzuari G.S. dhe mbrojtësi i tij, av. H.M., ndërsa edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantuan Prokurori i Apelit e as e dëmtuara A.S.. Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av. Xh.M., pasi më parë sqaroi disa nga pretendimet ankimore, theksoi se ngelë në tërësi pranë propozimeve si në ankesë, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit G.S., av. H.M., theksoi se ngelë në tërësi pranë pretendimeve ankimore dhe propozimeve të bëra, duke shtuar se vrasja është bërë në gjendje të afektit mendor. I akuzuari G.S., e mbështeti fjalën e mbrojtësit të tij.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/I.nr.56/17, të dt. 24 01.2017, ka propozuar që ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Prishtinë dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar të aprovohen si të bazuara dhe

aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë me burgim, kurse ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa dhe përgjigje të ankesës, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e kësaj gjykate përkitazi me këto shkelje.

Mbrojtësi i të akuzuarit, në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par. 7. 10 dhe 12 e lidhur me dispozitat e nenit 370 par. 7, 8 9 dhe 11 të KPPK, sepse sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, në arsyetim nuk janë dhënë të gjitha arsyerat për çdo pikë të aktgjykimit, ku nuk rezulton të jetë e qartë se çka është vërtetuar e çka nuk është vërtetuar, veçanërisht ka dështuar gjykata e shkallës së parë, në paraqitjen e arsyerave për faktet kundërthënëse dhe po ashtu, për mos aprovimin e propozimit të palëve. Sidomos, pra, gjithëherë sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, nuk i ka kushtuar rëndësi as provave materiale dhe atë sidomos ekspertizës së psikiatrisë të punuar nga ekipi i mjekëve Dr. F.D., Dr.V.B.-R.,Dr. A.B. dhe Dr. V.Q., ku konstatohet çrregullimi i personalitetit tek i akuzuari, e që ka ndikuar drejtë për së drejti në çështjen e afektit mendor. Në rastin konkret në këtë çështje penale - juridike, edhe pse gjykata e shkallës së parë, e aprovon propozimin e mbrojtësit të akuzuarit për të caktuar ekspertët profesional për ekspertizë, prapë se prapë nga ekspertët në fjalë nuk janë dhënë argumente të mjaftueshme përkitazi me veprimin e të akuzuarit nën ndikimin e efektit mendor, kur merret parasysh, se i akuzuari i gjetur para fyerjes së rëndë në momentin kritik edhe ka kryer vepër penale në afekt mendor, e që pastaj, nuk është marrë fare parasysh gjendja e tij shëndetësore e mëhershme, sidomos vërtetimi – fletë lëshimi i UÇPMB, i dt. 05.04.2001. Po ashtu, gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, edhe përkundër ekspertizës psikiatrike si dhe prezencës së ekspertëve në seancën e shqyrtimit gjyqësor për plotësimin e ekspertizës në fjalë gjykata e shkallës së parë, në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk lejojë hapësirë të mjaftueshme për parashtrimin e pyetjeve dhe sqarimeve të mjaftueshme të ekspertëve në fjalë, gjegjësisht, për konkludimet e dhëna në ekspertizën e tyre, se i akuzuari a vuan nga sëmundja shpirtërore, se sa ka mundur të ndikojë sëmundja e tillë në gjendjen shëndetësore të akuzuarit, sidomos se sa ka mundur të ndikojë që i akuzuari të veprojë në gjendje të afektit mendor, për çka gjykata edhe ashtu ka poseduar prova tjera të mjaftueshme në shkresa të lëndës dhe atë duke filluar nga ato të Qendrës së Paraburgimit ku ka qëndruar i akuzuari, por njëkohësisht ka pasur edhe dokumente tjera që nga koha e luftës e që nuk u morën fare parasysh, ku i akuzuari në atë kohë nga UÇPMB, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore

lëshohet në pushim, por përkundrazi gjykata e shkallës së parë, e mori parasysh vetëm deklaratën e të akuzuarit të dhënë në procedurë paraprake, i cili deklaroi se nuk ka qenë asnjëherë më parë i sëmurë. Pastaj, gjykata e shkallës së parë, nuk e merr fare parasysh edhe fyerjen që i bëri të akuzuarit në momentin kritik tani i ndjeri R.S., duke i thënë “nuk po të njoh, kush je, dil jashtë rrugaç”, sjellje kjo e mjaftueshme që të akuzuarin ta sjellë në atë gjendje që i njëjti të mos jetë i aftë t’i kontrollojë veprimet e tij dhe të veprojë nën ndikimin e tronditjes së rëndë mendore – pra në afekt mendor. Pastaj, po ashtu, nuk janë marrë fare parasysh provat e dorëzuara nga mbrojtja përmes parashtrësës së dt. 24.10.2013, dhe atë nga numri rendor 1 deri në 19, por vetëm konstaton se ka pranuar provat në fjalë, por kur është fjala tek besimi i tyre, gjykata e shkallës së parë, nuk bënë fare analizë të tyre veç e veç, e pastaj të paraqesë vlerësimin real për secilin prej tyre, ngase, sikur të bënte një gjë të tillë, me siguri që do të konstatonte gjendje krejt tjetër faktike, e me këtë edhe do të evitohet shkelja e ligjit penal, të cilën gjykata e shkallës së parë e bënë kur të akuzuarin e shpallë fajtor për vepër penale vrasje e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 9 të KPK-së. Gjithashtu, në ankesë pretendohet se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 9 të KPK-së - pra, për formën cilësuese të vrasjes, ngase, me asnjë veprim inkriminues të akuzuarit të përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, nuk plotësohen elementet e hakmarrjes së paskrupullt, sikur që konstatohet në aktgjykimin e ankimuar, ngase, një gjë e tillë përveç që nuk vërtetohet as nga provat në shkresat e lëndës, këtë nuk e vërtetojnë as deklaratat e dy dëshmitarëve okular të vendit të ngjarjes A.B. dhe A.A., të cilët deklarojnë se në momentin kritik, i akuzuari ka qenë krejtësisht i qetë dhe plotësisht i vetëdijshëm dhe ka pritur në mënyrë normale që ta takojë tani të ndjerin R.S., mirëpo, kur futet në zyrën e tani të ndjerit, atëherë nga vetë sjellja e tani të ndjerit, e që gjykatës së shkallës së parë as që i ka interesuar, ka qenë shkaku kryesor që i akuzuari të vendos ta privojë nga jeta tani të ndjerin, e duke vepruar, pra, kështu në gjendje të afektit mendor, i vënë pa fajin e tij.

Si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura më lartë, pretendohet se aktgjykimi i ankimuar përkitazi me veprën penale vrasje e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 9 të KPK-së, duhet anuluar dhe çështja të kthehet në rivendosje, ndërsa, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par 1 të KPK-së nuk thuhet asgjë pasi që i akuzuari edhe ashtu e ka pranuar fajësinë, për çka po ashtu gjykata e shkallës së parë, me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë dhe i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ndërsa, me ankesë kërkohet vetëm shqiptimi i dënimit më të butë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara ngase nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 par.1 nën par. 7, 10 e 12 e lidhur me nenin 370 par. 7, 8, 9 dhe 11 të KPPK, ngase, dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, në të po ashtu janë paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 9 të KPK-së, duke nënkuptuar edhe ato veprime inkriminuese që përbëjnë elementet cilësuese të veprës penale në fjalë, pra, të hakmarrjes së paskrupullt. Po ashtu, në arsyetimin e tij janë dhënë arsyeza të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penalo - juridike, pra, për të gjitha pikat e aktgjykimit, duke përfshirë edhe faktet kundërthënëse, sidomos, ato përkitazi me rrethanat cilësuese të veprës penale, pra, të hakmarrjes së paskrupullt, duke marrë parasysh veprimet konkrete të akuzuarit në momentin kritik, e që të njëjtat veprime inkriminuese, përveç, deklaratës së vetë të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes, e duke i ndërlidhur faktet në fjalë edhe me konkludimet, gjegjësisht të gjeturat e ekspertizës psikiatrike, pra, janë dhënë arsyeza të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par. 2 të KPPK, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par.7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyerash i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe ekspertizën e psikiatrisë, pastaj deklaratat e ekspertëve në fjalë të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e të cilat edhe ashtu nuk ndryshojnë në kuptim të vërtetimit të fakteve themelore, por edhe deklaratat e dëshmitarëve okularë, sidomos përkitazi me vërtetimin e fakteve dhe rrethanave se a veproi i akuzuari nën ndikimin e afektit mendor, sikur që pretendohet në ankesë, apo pikërisht si shkak i hakmarrjes së paskrupullt, sikur që ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, pra si veproi i akuzuari në rastin konkret kur e kreu veprën penale, vepër kjo penale e cila u cilësua edhe si vrasje e rëndë, mu për shkak se u krye për shkak të hakmarrjes së paskrupullt, ngase sikur që deklarojnë edhe dëshmitarët, por nuk e konteston as vetë i akuzuari, se ditën kritike ka shkuar tek i ndjeri që të bisedojë me të njëjtin me arsyetim se e ka lënë në rrugë, pra, pa punë, duke e arsyetuar këtë se për konkursin e shpallur për vendin e punës në shkollën filllore të fshatit Koliq, për arsimtar të biologjisë, të akuzuarin nuk e kanë ftuar fare në intervistë, gjë që, gjithherë sipas deklaratës së dëshmitarit, këtë e kanë bërë pasi që i akuzuari në vitin paraprak mësimor e kishte shkëputur marrëdhënien e punës pa paralajmërim dhe pastaj komisioni nuk e ka ftuar fare për intervistë, për çka pastaj i akuzuari, duke e konsideruar për këtë fajtor tani të ndjerin R.S., ditën kritike pasi më parë futet në zyrën e tani të ndjerit dhe e pret derisa e përfundon bisedën telefonike në zyrën e tij të punës dhe pasi më parë i drejtohet me fjalët “se më ke lënë në rrugë” pa marrë fare përgjigjen nga tani i ndjeri e nxjerrë revolen nga çanta e tij dhe pasi e përgatit për të shtënë, në afërsi prej 2 m, qëllon në tani të ndjerin dhe atë shtatë herë

radhazi, duke e lënë kështu të vdekur në vendin e ngjarjes, fakte këto që i vërtetojnë, përveç dëshmitarëve, i akuzuari, vërtetohen edhe me provat materiale në shkresat e lëndës, e që lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Prandaj, përveç që qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme, po ashtu, as një fakt nuk ka ngelur dubioz ose i pavërtetuar dhe përveç që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe po ashtu përkitazi me dashje dhe motivin e kryerjes së veprës penale, ku përveç ekspertizës psikiatrike, nga e cila është konstatuar se i akuzuari ka qenë në gjendje për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e veta, janë marrë parasysht edhe deklaratat e dëshmitarit A.A., F.Z. e A.B., dëshmitarë këta nga të cilët, është vërtetuar se i akuzuari në momentin kritik, krejtësisht në mënyrë normale ka ardhur në objektin e Komunës për të biseduar me tani të ndjerin R.S., ku pasi pret një kohë të caktuar sipas sugjerimeve të personelit të zyrës së tani të ndjerit, pas pak futet në zyrën e tani të ndjerit dhe pa pritur dëgjohen të shtëna nga arma, ndërsa i akuzuari krejt i qetë dhe në mënyrë normale e lëshon vendin e ngjarjes kurse tani të ndjerin R.S., e gjejnë të vdekur në karrigen e tij, prandaj, pa dyshim se i akuzuari ka vepruar me dashje direkte për ta privuar nga jeta tani të ndjerin dhe atë me të vetmin motiv duke e konsideruar fajtor për shkak të mospranimit të akuzuarit në marrëdhënie pune në shkollën fillore të fshatit Koliq. Gjithashtu, në rastin konkret janë dhënë arsye të mjaftueshme edhe përkitazi me gjendjen shëndetësore të të akuzuarit, duke konstatuar se i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm kur ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë elementet qenësore të veprës penale në fjalë, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, prandaj, nuk qëndron pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë, nuk ka marrë parasysht ekspertizën e psikiatrisë dhe atë, gjykata e shkallës së parë e ka dhënë vlerësimin e saj edhe për pjesën e ekspertizës ku thuhet se tek i akuzuari janë konstatuar simptome – çrregullime të personalitetit të ashtuquajturat skizoid, sëmundje kjo mendore e klasifikuar sipas standardeve profesionale, por që, pra gjithherë sipas ekspertizës në fjalë, e njëjta nuk ka pasur ndikim të atij niveli që tek i akuzuari të ndikojë në aftësinë e të kuptuarit dhe kontrollimit të veprimeve të veta. Ndërsa, për faktin se a veprimi i akuzuarit në afekt mendor apo jo, përveç ekspertizës në fjalë, gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysht edhe deklaratat e dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes, të cilët në detaje kanë shpjeguar momentin kur i akuzuari është futur s'pari në korridorin e ndërtesës e duke pritur kështu një kohë të caktuar, e pastaj me t'u futur në zyrën e tani të ndjerit, vetë i akuzuari ka deklaruar se tani i ndjeri, as që ka arritur të jap përgjigje, që do të thotë se nuk ka qenë i provokuar në kurrfarë mënyre, por menjëherë pasi i akuzuari i drejtohet me fjalët “më ke lënë në rrugë”, pa u përgjigjur fare tani i ndjeri i akuzuari e nxjerrë armën e tij nga çanta - të cilën pra më parë e kishte marrë me vete, e po ashtu, të mbushur me municion dhe krejt në mënyrë të qetë e bënë përgatitjen - raportimin e armës duke e tërhequr pra drynin dhe pastaj po ashtu, në mënyrë të qetë qëllon shtatë herë radhazi në tani të ndjerin e duke e lënë të vdekur në vendin e ngjarjes, fakte këto dhe rrethana që vërtetohen edhe

me prova materiale, si shikimi në vendin e ngjarjes, skica dhe foto dokumentacioni, raporti mjeko - ligjor i obduksionit dhe shkresat tjera në lëndë, e që plotësojnë të gjitha elementet e hakmarrjes së paskrupullte e kursesi nuk mund të flitet për afekt mendor, sikur që pretendohet me ankesë. Po ashtu, është për t'u theksuar se gjykata e shkallës së parë, ka pasur parasysh edhe provat materiale të propozuara nga mbrojtja, sikur që është edhe vërtetimi i lëshuar nga UÇMPB, për të cilën e ka dhënë vlerësimin e saj, e duke marrë parasysh edhe provat tjera materiale të propozuara nga mbrojtësi i të akuzuarit, por, edhe përkundër provave në fjalë, gjykata me të drejtë ka konstatuar se i akuzuari ka qenë i aftë për kontrollimin e veprimeve të veta, sikurse edhe për kuptimin e rëndësisë së veprimeve të tij, në kuptim pra të dashjes dhe motivit të kryerjes së veprës penale. Po ashtu, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme edhe për propozimet e refuzuara të palëve e sidomos propozimin e mbrojtjes për ekspertizë tjetër psikiatrike, duke konstatuar kështu se me ekspertizën në fjalë por edhe deklaratat e ekspertëve në seancat e shqyrtimit gjyqësor, janë vërtetuar të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me gjendje shëndetësore të akuzuarit, pra, edhe përkitazi me atë se a veprimi i akuzuarit në ndikimin e afektit mendor apo jo, për çka më në detaje do të flitet edhe gjatë elaborimit të bazës ankimore, vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në këtë çështje penale-juridike, prandaj me të drejtë është refuzuar edhe propozimi për dëgjimin edhe të dëshmitarëve të tjerë, prandaj edhe në këtë aspekt nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së si dhe shkeljeve tjera esenciale të cekura më detajisht në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal si dhe gjetjet e gjykatës përkitazi me shkeljet në fjalë.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, në ankesë në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë në bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, prandaj edhe përfundimet kanë pasuar të gabuara, pa mbështetje në prova, për çka të akuzuarin, është dashur ta shpallë fajtor për veprën penale të vrasjes në afekt mendor apo eventualisht edhe vepër penale të vrasjes së rëndomtë - pra, nga neni 146 të KPK-së, e jo sikur që është vepruar nga gjykata e shkallës së parë. Kjo për arsye se gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, gjykata e shkallës së parë edhe përkundër dëgjimit të shumë dëshmitarëve, vetë të akuzuarit, provave materiale në shkresat e lëndës nga vendi i ngjarjes, angazhimi pastaj i ekspertëve të psikiatrisë e edhe vetë ekspertizës së psikiatrisë, përsëri nuk ka arritur ta vërtetojë gjendjen faktike, ngase, duke pasur parasysh gjendjen e të akuzuarit në momentin kritik para se të futej tek tani i ndjeri, atëherë, mu sjellja e tani të ndjerit ndaj të akuzuarit ka qenë arsyeja kryesore që i akuzuari duke e ndjerë veten të fyer e të tronditur, ka shtënë në tani të ndjerin, që do të thotë i njëjti ka vepruar nën ndikimin e

afektit mendor ose eventualisht mund të flitet edhe për vrasje të rëndomtë, por kurrsesi për vrasje të kualifikuar, pra të rëndë, gjegjësisht vrasje të kryer nga hakmarrja e paskrupullt, sikur që është vendosur nga gjykata e shkallës së parë, për çka pretendohet se me këtë është bërë edhe shkelje e ligjit penal në dëm të akuzuarit, kur është shpallur fajtor për veprën penale si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë, ngase, në këtë çështje penale - juridike nuk janë kontestuese rrethanat përkitazi me vendin ku është kryer vepra penale, veprimet e ndërmarrë nga i akuzuari, vendi ku janë shkaktuar lëndimet trupore të tani të ndjerit, e si rezultat i të cilave ka ardhur edhe te vdekja e tani të ndjerit, por kontestuese ngelin në rastin konkret rrethanat përkitazi me elementin subjektiv të veprës penale, pra, lidhur me dashjen e të akuzuarit, duke potencuar se i akuzuari, nuk ka pasur dashje gjegjësisht qëllimin që të privojë nga jeta tani të ndjerin, por se i njëjti i ka ndërmarrë veprimet inkriminuese pa fajin e tij, ngase, pasi shkon te tani i ndjeri për tu konsultuar për arsyerat e refuzimit të ankesës së tij dhe mos thirrjes së të akuzuarit fare në intervistë, i njëjti i përgjigjet në mënyrë të provokuar dhe fyese dhe si rezultat i sjelljes së tani të ndjerit por edhe i gjendjes shëndetësore të akuzuarit nga e kaluara, vije deri te sjellja e të akuzuarit në gjendje të afektit mendor dhe pastaj, i njëjti nën ndikimin e afektit mendor i ndërmerr veprimet inkriminuese në drejtim të privimit nga jeta të tani të ndjerit e që, sipas pretendimeve ankimore i akuzuari kryen vepër penale të vrasjes në afekt mendor ose eventualisht edhe vepër penale të vrasjes nga neni 146 të KPK-së, por kurrsesi vrasje të rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 9 të KPK-së, për të cilën edhe e ka shpallur fajtor gjykata e shkallës së parë, e çka, pra gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit G.S..

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore përkitazi me këtë bazë ankimore, po ashtu nuk qëndrojnë, ngase, në bazë të provave të prezantuara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, por edhe vetë mbrojtjes së të akuzuarit, vërtetohet se ditën kritike i akuzuari, kishte shkuar tek tani i ndjeri ku pasi më parë futet në objektin e Komunës së Prishtinës, shkon tek zyra e Drejtorit të DKA-së, tani të ndjerit R.S., dhe pasi pret pak në korridor sipas udhëzimit të personelit të zyrës së drejtorit, në momentin kur personeli në fjalë habitet mbas punëve tjera, i akuzuari futet në zyrën e tani të ndjerit, i cili – pra, tani i ndjeri ishte duke biseduar me telefon dhe pasi e përfundon bisedën telefonike tani i ndjeri, i akuzuari ia prezanton në tavolinë ankesën e tij me shkrim që i ishte refuzuar dhe pastaj i drejtohet me fjalët “më ke lënë në rrugë”, dhe pa marrë fare përgjigje nga tani i ndjeri, i akuzuari nga qanta e tij që e kishte me vete e nxjerrë revolen dhe pasi më parë ia heqë bllokadën armës së tij e cila ishte e mbushur plotë me municion, qëllon në tani të ndjerin dhe atë shtatë herë radhazi, i cili pastaj krejt në mënyrë të qetë e lëshon vendin e ngjarjes dhe i dorëzohet policisë, ndërsa, tani i ndjeri nga plagët e pësuar mbetet i vdekur në vendin e ngjarjes. Po nga deklarata e të akuzuarit të dhënë në fazën paraprake – pra, menjëherë pas ngjarjes, e që gjykata e shkallës së parë, pasi të njëjtën e krahason edhe me prova tjera në shkresa të lëndës, e

duke vlerësuar si të besueshme, ngase, pra gjithherë sipas aktgjykimit të shkallës së parë, e njëjta ka mbështetje edhe në deklaratat e dëshmitarëve, por edhe provat materiale në shkresa të lëndës, është vërtetuar se i akuzuari ditën kritike ka shkuar në zyrën e tani të ndjerit me qëllim që të njëjtin ta privon nga jeta e duke konsideruar kështu fajtor për faktin se i akuzuari nuk është pranuar në marrëdhënie pune në shkollën fillore të fsh. Koliq, si arsimtarë i biologjisë, e pasi që i njëjti – pra, i akuzuari konsideron se tash më janë shterrur të gjitha mundësitë tjera, vendos që ta vras tani të ndjerin, e që të tjerët mos të pësojnë sikurse i akuzuari por që edhe të tjerët të marrin mësim, për çka pastaj, edhe ka shkuar i akuzuari në zyrën e tani të ndjerit, i cili me vete në qantën e tij kishte marrë edhe revolen e markës “Crvena Zastava” të kalibrit 7.65 mm e me nr. serik C137581 të mbushur plotë me municion, ku edhe me të arritur ka privuar nga jeta tani të ndjerin R.S.. Faktet dhe rrethanat në fjalë i vërtetojnë edhe dëshmitarët A.B., inspektore e arsimit në Ministrinë e Arsimit, e cila deklaroi se përkitazi me ankesën e të akuzuarit të paraqitur kundër DKA-së, në Prishtinë, është punuar nga ana e inspektores në fjalë dhe e njëjta ka konstatuar se i akuzuari nuk është ftuar fare në intervistë për konkursin e shpallur për arsimtarë të biologjisë, në shkollën fillore të fsh. Koliq, në arsyetim se i njëjti një vit më parë, ka qenë duke punuar në marrëdhënie të rregullt në shkollën fillore të fsh. Dashec, dhe i njëjti pa paralajmëruar fare DKA-në në Prishtinë, e as drejtorin e shkollës e ka lëshuar procesin mësimor vetëm një muaj para përfundimit të vitit shkollor e duke ç’organizuar procesin mësimor, për çka, pastaj, gjithherë sipas deklaratës së dëshmitares, i akuzuari është njoftuar për arsyet e refuzimit të ankesës së tij, dhe njëkohësisht për këtë është informuar edhe tani i ndjeri si drejtor i DKA, i cili dëshmitares i ka premtuar se në momentin e parë që do të ketë orë të lira të biologjisë do t’i ipen të akuzuarit. Ndërsa, nga dëshmitarja tjetër F.Z., - asistente administrative e drejtorit të DKA-së, - tani të ndjerit R.S., gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se i akuzuari pas lajmërohet në zyrën e tani të ndjerit, nga zyrtarja në fjalë udhëzohet që të pres derisa i njëjti të lirohet, mirëpo në momentin kur zyrtarja në fjalë merret me punës të tjera, i akuzuari duke shfrytëzuar mungesën e saj, futet në zyrën e tani të ndjerit dhe pas pak dëshmitarja dëgjon të shtëna armësh, ku tani të ndjerin e gjen të vdekur, kurse i akuzuari me armë në dorë largohet nga zyra e tani të ndjerit, për çka pastaj duke qarë i alarmon edhe të tjerët në vendin e tyre të punës për ngjarje. Faktet dhe rrethanat në fjalë, i vërteton edhe dëshmitari tjetër A.A., ku gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se i akuzuari pak ditë më parë kishte qenë tek dëshmitari i cili është zyrtar i lartë i arsimit në DKA, për ta informuar për konkursin e shkollës fillore në fsh. Koliq, për arsimtar të biologjisë, duke i kërkuar përgjigje sepse nuk ka qenë i ftuar fare në intervistë, për çka dëshmitari e ka njoftuar se përkitazi me këtë duhet t’i drejtohet inspektorit të arsimit R.B., ndërsa, përkitazi me ditën kritike, dëshmitari në fjalë ka vërtetuar se ka dëgjuar të shtëna armësh dhe kur ka dalë në korridor e ka parë dëshmitarin tjetër duke qarë dhe duke shkukur flokët e sajë, ndërsa të akuzuarin më vonë e ka parë me armë në dorë e duke dalë nga objekti i komunës të cilit i drejtohet në pyetjen se çka ka ndodhur, por i njëjti me armë në dorë të drejtuar në dysheme e duke ecur i përgjigjet “qaty, qaty”, pra, duke aluduar kështu në drejtim të zyrës së tani të ndjerit.

Prandaj, duke i pasur parasysh rrethanat e rasti konkret, në të cilat është zhvilluar ngjarja kritike, se i akuzuari me revole të mbushur me municion ka shkuar në objektin e komunës, se para zyrës së tani të ndjerit ka pritur derisa i është dhënë rasti të futet në zyrën e tij, kur me të future në zyre ka pritur derisa i ndjeri ka përfunduar bisedën telefonike dhe pasi ia tregon ankesën me shkrim që i është refuzuar, të ndjerit i drejtohet me fjalët “më ke lënë në rrugë”, dhe tani pa marrë fare përgjigje nga tani i ndjeri, nxjerr armën nga çanta e tij të mbushur plot me municion dhe fillon të qëllojë me armën e tij dhe atë shtatë herë radhazi, që do të thotë pra, pa kurrfarë reagimi fizik apo verbal të tani të ndjerit, pastaj duke marrë parasysh vetë deklaratën e të akuzuarit se ka vendosur që ta vras tani të ndjerin duke e konsideruar fajtor që nuk është pranuar në marrëdhënie pune e me qëllim që të tjerët mos të pësojnë por që edhe të tjerëve t’iu jepet mësim për këtë, pastaj, ekspertizën psikiatrike ku janë vërtetuar faktet edhe përkitazi me gjendjen shëndetësore-pra llogaritshmërinë e të akuzuarit në momentin kritik, rezulton se tek i akuzuari qëndron elementi subjektiv i veprës penale, për të cilat është shpallur fajtor, pra qëndron fakti se i njëjti veprimet konkrete inkrimuese i ka ndër marrë me dashje dhe atë me dashje direkte - pra, për ta privuar nga jeta tani të ndjerin dhe me të vetmin motiv duke e konsideruar fajtor se pse i akuzuari nuk është pranuar në marrëdhënie pune në shkollën fillore të fsh. Koliq. Kështu që arsyet më të detajuara të dhëna në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në tërësi si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë, ngase të njëjtat kanë mbështetje në provat e prezantuara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, për çka po ashtu aktgjykimi i ankimuar përmban edhe arsye të mjaftueshme mbi të gjitha faktet vendimtare dhe në bazë të një gjendje të tillë faktike të vërtetuar rezulton se në mënyrë të drejtë janë aplikuar edhe dispozitat e ligjit penal. Prandaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, rrethanat në të cilat është zhvilluar ngjarja kritike, arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë, rezulton në mënyrë të qartë se është i drejtë konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se në veprimet inkrimuese të të akuzuarit, përmbushen të gjitha tiparet e veprës penale vrasje nga neni 147 par. 1 nën par. 9 të KPK-së dhe me këtë në mënyrë të drejtë dhe objektive janë zbatuar edhe dispozitat e Kodit Penal, prandaj nuk ka as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit sikur që pretendohet me ankesë.

Pretendimet ankimore përkitazi me sanksionin penal dhe gjetjet e gjykatës.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të Prokurorisë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, si dhe ato të mbrojtësit të akuzuarit, nuk janë të bazuara.

Në ankesën e Prokurorisë, përkitazi me këtë bazë ankimore, theksohet se gjykata e shkallës së parë edhe pse i ka numëruar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të njëjtat – pra ato rënduese nuk i ka vlerësuar realisht, por njëkohësisht nuk ka marrë parasysh edhe rrethanat tjera rënduese, si motivi i kryerjes së veprës penale, sjellja e pa mëshirshme e të akuzuarit në kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, ndërsa përfaqësuesi i palës së dëmtuar,

përkitazi me këtë bazë ankimore, thekson se gjykata e shkallës së parë, rrethanat lehtësuese të cilat i ka konstatuar nuk i ka vlerësuar drejtë, por përkundrazi të njëjtat i ka mbivlerësuar, ndërsa atyre rënduese nuk u ka kushtuar fare rëndësi, sidomos potencohet se i akuzuari ka qenë më parë i dënuar me dënim me burgim afatgjatë prej 35 vitesh, pastaj si rrethanë lehtësuese është konstatuar gabimisht sjella korrekte në gjykatë e të akuzuarit, pastaj rrethana se i akuzuari nuk ka qenë i dënuar po ashtu është konstatuar gabimisht e pastaj nuk ka marrë parasysh edhe disa rrethana tjera rënduese si motivin e ulët të kryerjes së veprës penale, sjelljen e kryesit pas kryerjes së veprës penale e që do të thotë se sikur të merreshin parasysh të gjitha këto të akuzuarit ishte dashur t'i shqiptohet dënim më i rëndë me burgim, për çka propozon ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar duke i shqiptuar të akuzuarit dënim më të lartë me burgim afatgjatë se që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë. Ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit, në ankesë përkitazi me këtë bazë ankimore konstaton se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është shumë i rëndë, sidomos kur dihet se nuk mund të bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes së rëndë, pastaj, më tutje shton se gjykata e shkallës së parë, nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese se; se i akuzuari në momentin e kryerjes së veprës penale ka pasur simptome të stresit post traumatik, se pas kryerjes së veprës penale i është dorëzuar policisë vullnetarisht se i njëjti ka shprehur pendim të thellë për kryerjen e veprës penale, se ka pranuar kryerjen e veprës penale – kuptohet duke e kontestuar vetëm cilësimin juridik të saj, pastaj nuk ka kryer vepër penale më parë, se i njëjti me profesion është arsimtar, për çka propozon që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim shumë më të butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në ankesat e paraqitura nuk prezantohet ndonjë rrethanë rënduese apo lehtësuese, të cilat kishin me pasur ndikim të drejtpërdrejtë në lartësinë e dënimit, ngase, në ankesën e prokurorisë më shumë bëhet vërejtje përkitazi me vlerësimin e rrethanave rënduese nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa rrethana tjera që potencohen nga prokuroria janë kryesisht elemente të veprës penale, pra, të formës cilësuese të veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor, ndërsa, përfaqësuesi i palës së dëmtuar, po ashtu, më shumë i konteston rregullat e përgjithshme për matje të dënimit, duke konsideruar se gjykata e shkallës së parë, gabimisht i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, ndërsa, përkitazi me ato rënduese, kryesisht i potencon ato rrethana që janë elemente kualifikuese të veprës penale, e që i akuzuari mu për atë edhe është shpallur fajtor, ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit më tepër aludon në faktin se në këtë çështje penale-juridike, më tepër bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes në afekt mendor, e kurrësi për vrasje të rëndë, prandaj, edhe konsideron se është dashur të akuzuarit t'i shqiptohet dënim shumë më i butë, ndërsa, rrethanat lehtësuese që theksohen shprehimisht, se i akuzuari është dorëzuar vullnetarisht, se është penduar, ka pranuar kryerjen e veprës penale, të gjitha këto edhe sikur të merreshin parasysh nga gjykata e shkallës së parë, prapë se prapë duke marrë parasysh shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale, rrethanat rënduese të konstatuara dhe të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, e sidomos rrethanat e kryerjes së veprës penale, ku pra, i akuzuari këtë e ka bërë në objektin e

komunës, në kohën kur i gjithë personeli ishte në punë, pastaj, në një vend ku për shkak të organizimit të sigurimit institucional është pritur të ndodhë më së paku një gjë e tillë, atëherë rrethanat lehtësuese të konstatuara nga mbrojtësi i te akuzuarit nuk janë të atij niveli që në krahasim me ato rënduese të merren si bazë e arsyeshme për zbutjen e dënimit, sikur që propozohet në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit.

Prandaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parasheh dispozita e nenit 73 të KPK-së, ngase, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana, rrethanat e cekura në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, mënyrën si është zhvilluar ngjarja ditën kritike, pastaj shkaktimin e pasojës së ndaluar, rezulton se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, po ashtu i njëjti është në funksion të preventivës gjenerale, por edhe asaj individuale dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitat e nenit 41 të KPK.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.44/2017, me dt. 09.03.2017

**Procesmbajtës,
Eroll Gashi**

Anëtarët e kolegjit,

**Kryetar i kolegjit,
Fillim Skoro**

- 1. Xhevdet Abazi**
- 2. Abdullah Ahmeti**